


MEDIA, BURIM



I PASHTERSHËM I INFORMATAVE

JETA NË DEMOKRACI

IRMA (14), ELBIONA (13), DRITA (13), DRILON (14), LEONIT (13), AMAR (13)



Të mirat që na i ofron demokracia

Ne jemi të lumtur që jetojmë në një vend demokratik. Në këtë formë të qeverisjes ne si qytetarë gëzojmë shumë të drejta. Të gjithë trajtohemi në mënyrë të barabartë pa dallim feje, gjinie, race, etj.


Demokracia rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ udhëheqje. Ajo për herë të parë është shfaqur në Athinë, në qytet-shtetin e Greqisë në vitin 507 para erës sonë. Për dallim nga sot, në atë kohë të drejtën e vendimmarrjes e kishin vetëm burrat e pasur. E ndërsa gratë dhe skllëvërit nuk e gëzonin këtë të drejtë. Tani të gjithë jemi të barabartë dhe mund të marrim vendime për vendin tonë. Në demokracinë e tanishme, i kemi këto të drejta: të drejtën për familje, të drejtën për lojë, të drejtën për strehim, të drejtën për kujdes shëndetësor, etj.

Le të imagjinojmë një situatë, në të cilën ne nuk do t'i kishim të drejtat e garantuara me ligj. Jeta në këtë rast do të ishte kaotike, e pasigurt dhe e padrejtë. Po sikur të mungonte e drejta për vendimmarrje dhe dikush tjetër të vendoste për ne? Nëse nuk do të ekzistonte liria e fjalës, si dhe e drejta e zgjedhjes, ne nuk do të kishim mundësi t'i shprehnim mendimet tona lirshëm. Po ashtu, nuk do të kishim mundësi të zgjedhnim gjërat që neve na pëlqejnë. Pra, populli në demokraci merr vendime. Populli është ai i cili udhëheq.

Pasi që Kosova ka demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar, populli merr vendime në mënyrë indirekte, me anë të përfaqësuesve, të cilët i voton në

procesin zgjedhor. Pastaj, ata përfaqësues marrin vendime për ne. Demokracia neve na sjell shumë të mira. Mirëpo, jemi ne ata të cilët vendosim pastaj a të tregohemi të përgjegjshëm apo jo.

Të dashur lexues, me anë të shembujve të cilët i përmendëm, mund ta shihni se si është të jetosh me demokraci dhe pa demokraci. Jemi pikërisht ne ata të cilët e bëjmë ndryshimin.




E drejta e kujdesit shëndetësor



Grupi „Demokratët e rinjë“

KUVENDI MENDON PËR NE

BLENDINA (14), ALMA (13), VJOSA (13), MUBESHIR (14), RINOR (13), REGJEP (13)



E ardhmja jonë varet shumë nga qeverisja të cilën e ka shteti ynë. E ne jemi me fat që kemi sistem demokratik të qeverisjes

Sistemi demokratik, i përmendur lart, na nevojitet që të kemi në mesin tonë barazi, respekt, tolerancë, solidaritet dhe liri. Po ashtu, sistemi në fjalë, na ka mundësuar që të kemi një institucion, që tërë punën e realizon në mënyrë që të gjithë qytetarët të jenë të sigurt dhe të gëzojnë të drejta të shumta. Institucioni për të cilin po flasim është Kuvendi. Puna e këtij in-

nga Kuvendi dhe Qeveria, i kemi të siguruara edhe librat shkollore. E tërë kjo rrjedh nga puna e Kuvendit dhe Ministrisë së Arsimit, e cila për qëllim ka krijimin e kushteve të domosdoshme për përvetësimin e shkollësive dhe njohurive. Po ashtu, qëllim tjetër i Ministrisë së Arsimit është promovimi i një sistemi arsimor jo diskriminues. Në kuadër të këtij sistemi, e drejta e secilit person për arsim respektohet dhe mundësitë e shkollimit cilësor vihen në dispozicion për të gjithë. Ashtu siç e dijme të gjithë, jo vetëm Ministria e Arsimit, por të gjitha ministratë që janë në kuadër të Qeverisë zgjedhen nga deputetët e Kuvendit, të cilët janë të përzgjedhur nga populli. Këtu shihet rëndësia e madhe e këtij institucioni ligjvënës në jetën tonë.

Prandaj, ne duhet të jemi qytetarë shumë të përgjegjshëm, duke qenë të respektueshëm ndaj ligjeve të vendosura aty. Po ashtu, asnjëherë nuk duhet të harrojmë respektimin e vlerave demokratike, sepse vetëm kështu ndërtohet Kosova edhe më tutje.



Gëzojmë të drejta të barabarta si gjithë të tjerët

stitucioni është shumë e rëndësishme për të gjithë. E sidomos për ne nxënësit të cilët jemi përfitues të sistemit edukativo-arsimor. E themi këtë, sepse e dijme që çdo ligj që del nga Kuvendi për synim ka përmirësimin e jetës sonë. Si rezultat, pjesë e shkollimit fillor dhe atij të mesëm të ulët e të lartë mund të jemi të gjithë, pa asnjë dallim. Për këtë ka menduar shteti ynë, sepse nga institucionet shtetërore, e në këtë rast



Jemi dëshmitarë të shtetit tonë demokratik

INFORMIMI I DREJTË VJEN NGA MEDIA

URAN (13), DONIKA (13), BLEND (14), SAMRA (14), LEON (13), DRILONA (14), ARLIND (14)



Mënyra më e mirë se si të marrim informata të sakta është përmes medias

Ne jemi nxënës të klasës së VIII-të dhe këtë vit shkollor kemi gjithsej 15 lëndë mësimore. Ka lëndë të cilat i kemi përvetësuar shumë mirë, por ka prej atyre në të cilat kemi nga pak vështirësi. Një ndër lëndët, në të cilën kemi nevojë të punojmë më shumë është gjuha gjermane. Kjo ndodh ngaqë në këtë lëndë kemi shumë pak orë mësimi gjatë javës. Por, ne si nxënës të zgjuar që jemi, pa dyshim që kemi gjetur një zgjidhje. Kemi kërkuar në internet dhe aty kemi gjetur disa video, të cilat na ndihmojnë shumë për mësimin e kësaj gjuhe. Ja dhe një shembull tjetër. Para disa ditësh, ka ndod-

hur diçka jo e këndshme në komunën tonë. Kjo ngjarje e hidhur ishte shpërndarë gjithandej, në lajme, në radio, në rrjete sociale, etj. Lajmi fatkeq kishte të bënte me një bashkëvendas tonë, i cili ishte kidnapuar. Prindërit e tij, të brengosur, kishin publikuar të dhënat e tij në media. Për fat të mirë, me ndihmën e këtyre mjeteve informuese, disa persona e kishin parë djaloshin e kërkuar në Fushë Kosovë. Përmes numrit kontaktues që prindërit e djaloshit e kishin lënë, qytetarët arritën ta lajmërojnë familjen e tij.

Këta ishin 2 shembuj, me të cilët ne dëshmuam se media është shumë e rëndësishme në jetën tonë dhe ajo na ndihmon shumë në çdo hap që ne e bëjmë.



Bashkëpunimi i kolegëve gazetarë ne mes vete



Autorët e artikullit të medias




Libri është burim informimi, i cili hyn tek media e shkruar



Teodori duke i ndihmuar Arlindit për idenë e vizatimit


Media është mjet informimi, prej së cilës ne marrim informata në forma të ndryshme, për të gjitha gjërat që neve na intereson të dijmë. Kemi dy lloje të medias: median e shkruar dhe atë elektronike. Në media të shkruara hyjnë: gazetat, librat, revistat, romanet, lektyrat, boletinët, etj. Ndërsa në media elektronike hyjnë: kompjuterët, telefonët, tabletët, radio, e po ashtu edhe rrjetet sociale (Viber, Facebook, Twitter, Instagram, etj.) Media na ndihmon në shumë gjëra, në shkollë, në punë, apo në përmbushjen e dëshirave tona, siç është dëgjimi i muzikës, shikimi i filmave, etj. Duhet të theksojmë se media duhet të mbështetet gjithmonë në informata të sakta, të cilat argumentohen me fakte. Kjo na bën ta vlerësojmë atë edhe më shumë.



Një medium të cilin e përdorim shumë shpesh



Drilona e pëlqen shumë muzikën. Çdo gjë që ajo dëshiron të dijë për muzikën, e gjen në internet



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Bedri Gjinaj“
Klasa: VIII & IX
Vendi: Mitrovicë